



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 12.09.2024

Nr: 20

Ora: 13:20

VENDIM
PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESAVE ANKIMORE NR. 9, DATË 03.08.2024 DEPOZITUAR NGA
PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE NR. 10, DATË 04.08.2024 ME
ANKUES Z. DHIONISIOS ALFRED BELERI

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 12.09.2024, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES:

- Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, përfaqësuar nga z. Vangjel Dule
- Z. Dhionisios Alfred Beleri, përfaqësuar nga Av. Klodjana Gjyzari

OBJEKT:

- Kundërshtim i vendimit nr. 69, datë 05.07.2024 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Data: 12.09.2024

Nr: 20

Ora: 13:20



“Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 9, datë 03.08.2024 depozituar nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut dhe nr. 10, datë 04.08.2024 me ankues z. Dhionisios Alfred Beleri”

BAZË LIGJORE:

Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, neni 123/1 dhe pika 3, e nenit 124 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Rrethanat e çështjes:

1. Z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, është propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, si kandidat për Kryetar të Bashkisë Himarë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Në datën 31.03.2023, pranë KQZ nga z. Beleri është depozituar formulari e vetëdeklarimit, i cili është regjistruar me numër unik VL-BF-13387. Në bazë Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, KQZ-ja bëri verifikimin “*prima facie*” të të dhënave që përmban ky formular dhe konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit.
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 611, datë 25.05.2023, i ka dhënë mandatin z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, si Kryetar i Bashkisë Himarë, detyrë e cila nuk është ushtruar nga ana e këtij të fundit pasi ka qënë i ndaluar më masë sigurimi “arrest në burg” vendosur nga autoritet gjyqësor penale.
4. Pasi është konstatuar që kandidati nuk është në kushtet e ndalimit për të kandiduar, janë verifikuar të dhëna të tjera në formularin e vetëdeklarimit të z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, ku rezultoi se ka deklaruar:
 - Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se ka bërë ndryshim në gjeneralitetet e tij. Ka ndryshuar emrin nga “Alfred” në “Dhionisios”.
 - Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1 “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”. ‘Dënuar nga Gjykata e Apelit, Athinë, me vendim gjyqësor të formës së prerë, me Nr.752 në vitin 1999, me 18 muaj burgim me 3 vjet kusht, për kryerjen e veprës penale, dijani (bashkëpunim) për veprën penale të mbajtjes së armëve pa leje, nga personi i tretë. (Nenet të legjislacionit grek 1244/1972, 2168/1993, 1780/1988, 652/1977). Për të cilën deklaroi se nuk ka kryer asnjë ditë burg.’
 - Pyetjes 3 - “A keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoriteti i huaj, për kryerjen e një veprë penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”. ‘Dijani (Bashkëpunim) në

mbajtje arme pa leje nga personi i tretë, nga Prokuroria, Athinë me 18 muaj burg me 3 vjet kusht, për periudhën 1995-1996.'

- Pyetjes 4 - “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues i është përgjigjur “PO”. '1 vit paraburgim, për periudhën 24.03.1995 - 24.03.1996 nga Prokuroria Athinë. (HETIME), 1 ditë ndalim për verifikim dokumentacioni, në datën 13.04.1999, nga Policia Kufitare, Aeroporti Athinë.'
- Pyetjes 5 - “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”.
'Paraburgim për periudhën 24.03.1995 deri më 24.03.1996 nga të cilat 3 muaj të kryera në Janinë për shkak se është bërë ndalimi, për veprën penale, dijani (Bashkëpunim) në mbajtje arme pa leje nga personi i tretë, nga Gjykata e Apelit, Athinë. (Nenet të legjislacionit grek 1244/1972, 2168/1993, 1780/1988, 652/1977).'
- Pyetjes 8 - “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO” 'Ka deklaruar se ka jetuar në Greqi, Zakynthos për arsye emigracioni, në periudhën 1990- 1993, në Qipro në periudhën janar 1994 -korrik 1994, 1994-2014 në Greqi.'

5. Nga konstatimet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4099 prot., datë 24.04.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklaramëve të bëra. Prokuroria e Përgjishme nuk ka kthyer ende përgjigje për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit.
6. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa me nr. 1719 prot., datë 26.06.2023 nga z. Eugen Likaj nëpërmjet të cilës kërkohet konstatimi i përfundimit të parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
7. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1736 prot., datë 27.06.2023 i ka kërkuar informacion/dokumentacion Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nëse është marrë ndonjë vendim penal në ngarkim të shtetasit z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri.
8. Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me shkresën nr. 933/1 prot, datë 1.7.2024, ka dërguar në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shkurtimin e vendimit nr. 26, datë 25.06.2024, dhënë në ngarkimi të të pandehurve Pandeli Kokoveshi dhe Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, me të cilin ka lënë në fuqi vendimin nr. 14, datë 05.03.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ky vendim i jepte formë të prerë deklarimit fajtor të të pandehurit Dhionisios Alfred Beleri, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 328 e 25 të Kodit Penal dhe dënimit të tij me 2 (dy) vite burgim.

këshilltar dhe me profesion jurist!!!). Për këto arsye, KAS, pasi u konsultua, vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë dhe vijimin e seancës së shqyrtimit.

16. Pala ankuese pretendon se:

- *Nuk mund të ketë kundërshti më flagrante të dispozitave që rregullojnë kompetenën se veprimi në mungesën totale të saj, apo duke marrë kompetencat e organeve të tjera;*
- *Nuk mund të ketë shkelje më të rëndë të procedurës së veprimit mbi bazën e kërkesës së një subjekti të palegjitimuar (pra pa kërkesë), pa nisur një procedurë administrative kryesisht, pa respektuar asnjë të drejtë të subjektit të verifikuar, duke vepruar në kundërshtim me nenet 5-10 të ligjit nr. 138/2015 dhe duke u shprehur jashtë kufijve të kërkesës, mbi të cilën ka nisur procedimi administrativ;*
- *Nuk mund të ketë shkelje më të rënde të kërkesave të ligjit për formën e aktit administrativ, se mungesa e arsytimit ligjor të tij;*
- *Pavlefshmëria absolute e aktit të kundërshtuar, siç po e vëmë në dukje, mund të konstatohet edhe kryesisht prej organit administrativ që merr në shqyrtim mjetet ankimore dhe në këto kushte, për të bërë objekt të shqyrtimit të gjitha shkeljet ligjore të sipërpërmendura*

17. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën Ankimore nr. 9, depozituar nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut;
- Kërkesën Ankimore nr. 10, depozituar nga z. Dhionisios Alfred Beleri;
- Vendimi nr. 69, datë 05.07.2024 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Vendimin nr. 611, datë 25.05.2023 “Për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe në tërësi aktet e dosjes të shqyrtimit administrativ të administruara nga KSHZ,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstatoi se:

1. Ankuesi Dhionisios Alfred Beleri është zgjedhur kryetar bashkie i bashkisë Himarë në zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Ankuesi është arrestuar në datën 12.05.2023 dhe, për shkak të masës së sigurimit personal, nuk ka bërë betimin dhe nuk ka qenë asnjë ditë në kushtet e ushtrimit të mandatit. Në këndvështrim të ligjit, ankuesit ka qenë i zgjedhur në postin e kryetarit të bashkisë

Data: 12.09.2024 Nr: 20
Ora: 13:20



“Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 9, datë 03.08.2024 depozituar nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut dhe nr. 10, datë 04.08.2024 me ankues z. Dhionisios Alfred Beleri”

Himarë, por nuk ka qenë për asnjë moment kryetar bashkie në detyrë. Ky status është thelbësor për trajtimin ligjor të pretendimeve të ankuesit.

2. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton në nenin 115 të saj se “*organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësisë qeverisëse vendore mund të shpërndahet ose të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve*” dhe se “*organi i shpërndarë ose i shkarkuar mund të ankohet në Gjykatën Kushtetuese brenda 15 ditëve, dhe në këtë rast vendimi i Këshillit të Ministrave pezullohet*”. Kjo dispozitë e Kushtetutës nuk ka qëllim që të përcaktojë kompetencën në rastin e shkarkimit të kryetarit të bashkisë, por ka qëllim që të mbrojë pavarësinë e organeve të qeverisjes vendore nga ndërhyrjet e pushteteve të tjera. Ajo nuk shpreh një kompetencë kushtetuese, por shpreh një kufizim kushtetues. Kufizimi kushtetues i drejtohet legjislativit dhe ekzekutivit.
3. Kompetenca për shkarkimin e organit të qeverisjes vendore rregullohet nga ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar”, i cili në nenin 62 të tij përcakton se “*kryetari i bashkisë shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave në rastet kur:*
 - a) kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve;
 - b) dënohet për kryerjen e një vepre penale, me vendim të formës së prerë, nga gjykata;
 - c) propozohet për shkarkim nga këshilli bashkiak përkatës për mosparaqitje në detyrë për një periudhë 3-mujore të pandërprerë”.

Leximi i dispozitës tregon qartë se shkarkimi i kryetarit të bashkisë nuk bëhet vetëm për “shkakun kushtetues” (*shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve*), por shkarkimi bëhet edhe kur vërtetohen fakte juridike të pavarura nga vullneti i Këshillit të Ministrave (*dënimi me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe mosparaqitja në detyrë për një periudhë 3-mujore të pandërprerë*). Diferenca qëndron në faktin, se kur ndodh shkarkimi për shkaqe kushtetuesese, mbrotja bëhet me instrumenta kushtetuese (Gjykata kushtetuese), kurse për rastet e tjera, palët e prekura mund të shfrytëzojnë vetëm instrumentat administrative të mbrotjes dhe t’i ngrejnjë pretendimet në gjykatën kompetente administrative dhe jo sipas procedurës së posaçme që përcakton neni 115 i Kushtetutës.

4. Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar” përcakton edhe shkaqe të tjera të mbarimit para kohe të mandatit të kryetarit të bashkisë, përveç shkaqeve që çojnë në shkarkim sipas nenit 62 të tij. Kompetenca për konstatimin e faktit juridik në të gjitha këto raste (neni 61 i ligjit) i takon këshillit bashkiak përkatës. Edhe në këto raste nuk zbatohet procedura e posaçme e nenit 115 të Kushtetutës.
5. Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” ka hyrë në fuqi me qëllimin për të penguar zgjedhjen ose emërimin në organet e zgjedhura shtetërore, institucionet e pavarura dhe ato të krijuara me ligj, të administratës publike,

apo largimin nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve, sipas përcaktimeve në këtë ligj (neni 1).

6. Ligji nr. 138/2015 i njëj KQZ-së kompetencën dekriminalizuese “për të zgjedhurit dhe kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë apo në organet e qeverisjes vendore”, si dhe “për anëtarët e Këshillit të Ministrave që nuk kanë mandat deputeti”(shkronjat “a” dhe “ç” të pikës 4 të nenit 5). Neni 8 i ligjit përcakton në pikën 1 të tij se “drejtuesi i institucionit që, sipas nenit 5, të këtij ligji, është i ngarkuar për marrjen e kërkesës për verifikim, është organi kompetent për zbatimin e ndalimeve, sipas këtij ligji. Kështu që, kompetenca e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për lëndën e dekriminalizimit sa i takon të zgjedhurve vendorë është jashtë çdo lloj dyshimi.
7. Çështja që shtrohet është se çfarë tagrash pushteti i njëj ligji Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në funksion të kompetencës për të mbajtur pastër institucionet shtetërore? Komisioneri padyshim që ka kompetencën për të administruar formularët e vetdeklarimit që dorëzojnë pranë tij kandidatët dhe funksionarët e specifikuar në nenin 5 të ligjit. Gjithashtu Komisioneri ka tagrin të verifikojë *prima facie* të dhënat e vetdeklarimit, për të zbuluar nëse subjekti ndodhet në kushtet e ndalimit, ose nëse të dhënat e deklaruara sugjerojnë kryerjen e verifikimit të thelluar. Verifikimi i thelluar është kompetencë e organit të prokurorisë, por Komisioneri është organi që vë në lëvizje prokurorinë në këtë rast. Për këto tagra, ligji ka përcaktuar shprehimisht procedurën që duhet të ndiqet.
8. Përveç sa më sipër, Komisioneri ka tagër:
 - a) të refuzojë kandidaturën e personit, kur kushtet e ndalimit vërtetohen para procesit të pranimit të kandidaturave;
 - b) të heqë kandidatin nga kandidimi kur kushtet e ndalimit vërtetohen para shtypjes së fletëve të votimit;
 - c) të shpallë pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore përkatëse, për personin e zgjedhur kryetar bashkie, si dhe të përjashtojë nga përllogaritja e mandateve kandidatin e propozuar nga zgjedhësit për këshilltar në këshillin e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe të përllogaritë mandatet, duke përjashtuar votat e marra prej tij, kur kushtet e moskandidimit verifikohen pas shtypjes së fletëve të votimit dhe para shpalljes së rezultateve;
 - ç) të shpallë pavlefshmërinë e mandatit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe para fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi i shpallur i zgjedhur në kundërshtim me këtë dispozitë;
 - d) të shpallë pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi përkatës.

Në të gjitha këto raste, vendimi i Komisionerit i jep fund “ëndrrës” së subjektit për pushtet ose, sipas rastit, karrierë politike. Akti i Komisionerit është akt që sjell drejtpërdrejt pasojat juridike që priten prej tij, nuk është as kërkesë as propozim për një institucion tjetër epror ose për një institucion që i përket ndonjë dege tjetër të pushtetit. Në këto rrethana, mund të thuhet me bindje, se kjo procedurë nuk mund të ketë asnjë lidhje ligjore me procedurën sipas nenit 115 të Kushtetutës dhe me procedurën sipas neneve 61 dhe 62 të ligjit nr. 139/2015. Edhe nëse shohim ngjashmëritë do të dalim lehtësisht në konkluzionin, se tagri që buron nga shkronja “b” e nenit 62 të ligjit nr. 139/2015 dhe tagri që buron nga shkronja “d” e pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr. 138/2015, ndonëse në pamje të ngjashëm, në fakt janë konkurrues me njeri tjetrin. Tagri sipas ligjit nr. 138/2015 vepron vetëm për një kategori specifike veprash penale, kurse tagri sipas nenit 62 të ligjit nr. 139/2015 vepron për të gjitha veprat penale.

9. Për tagrat e përcaktuara në nenin 10 të ligjit nr. 18/2015 nuk është specifikuar ndonjë procedurë e posaçme, sikurse është bërë për administrimin e vetdeklarimeve dhe për verifikimin e thelluar të tyre. Kjo nuk do të thotë se tagrat e sipërcituar mund të ushtrohen vetëm në kuadër të procedurës së administrimit të vetdeklarimeve apo të verifikimit të thelluar. Ligji nuk ka përcaktuar procedurë, sepse në këtë rast mjaftojnë rregullat proceduriale të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, për ushtrimin e të gjitha tagrave të përmendura në këtë nen.
10. Komisioneri ka vendosur të shpallë të pavlefshëm mandatin e Kryetarit të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, të fituar nga z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri bazuar në nenin 10, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Siç provohet nga rrethanat e çështjes dhe nga dokumentacioni provues, ankuesi nuk ka qenë asnjë ditë në kushtet e ushtrimit të mandatit, sepse nuk ka bërë betimin, i cili është kusht për fillimin e ushtrimit të tij. Kjo është arsyeja pse nuk mund të vendoset “mbarimi i parakohshëm i mandatit”, sikurse referohet në dispozitivin e vendimit nr. 69, datë 05.07.2024 të Komisionerit (tagër që buron nga shkronja “d” e të njejtës pikë të ligjit). Por dispozita ligjore e referuar si bazë për marrjen e vendimit demonstroi qartë vullnetin e organit kompetent. Komisioneri ka pasur qëllim dhe, në fakt, ka shpallur pavlefshmërinë e mandatit të ankuesit, për shkak të vërtetimit të kushteve të moskandidimit dhe të moszgjedhshmërisë, pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe para fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi i shpallur i zgjedhur.
11. Ankuesi nuk ngriti në seancë asnjë pretendim lidhur me vërtetësinë e shkakut ligjor “të moskandidimit dhe të moszgjedhshmërisë” apo lidhur me faktin, nëse dënimi i tij me vendim të formës së prerë përfshihej në fushën e veprimit të ligjit nr. 138/2015. Pavarësisht nga kjo, KAS gjykon se është me vend të analizojë dhe këtë aspekt, për t’i dhënë përgjigje pyetjes: A ndodhet ankuesi në kushtet e ndalimit, apo jo?
12. Ankuesi Dhionisios Alfred Beleri është dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të cilin i është dhënë formë e prerë deklarimit fajtor të të pandehurit Dhionisios Alfred Beleri, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 328 e 25 të Kodit Penal. Gjykata e ka dënuar ankuesin me 2 (dy) vite burgim.

13. Dënimi për veprën penale të “Korrupsionit aktiv në zgjedhje”, sipas nenit 328 të Kodit Penal nuk përbën në vetvete kusht ndalimi sipas ligjit nr. 138/2015, sepse nuk përfshihet në listën e veprave të cituara nga shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të neni 2 të këtij ligji, për të cilat vepron ndalimi. “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, me fjalë të tjera “blerja e votave”, delegjtimon fitoren dhe zgjedhjen si të tillë, sidomos kur diferenca midis fituesit dhe humbësit është e ngushtë (në rastin e ankuesit vetëm 19 vota), por delegjtimimi nuk e fut dot në veprim automatikisht ligjin nr. 138/2015.
14. Dënimi me 2 vite burgim, në të kundërt, formon shkak ligjor për veprimin e ligjit nr. 138/2015, sepse masa e dënimit është kusht i mëvetësishëm për futjen në veprim të këtij ligji. Shkronja “ç” e pikës 1, të nenit 2 të ligjit përcakton se *“nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak, dhe në çdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë... për kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim”*. Komisioneri ka referuar me të drejtë tek ky shkak ligjor kur ka vendosur papajtueshmërinë e mandatit për ankuesin.
15. Kjo analizë demonstroi qartë se, për çështjen në shqyrtim, ekziston ligji që ndalon ankuesin të ushtrojë mandatin e kryetarit të bashkisë, ekziston kompetenca ligjore e Komisionerit për të vendosur ndalimin dhe se ekziston, gjithashtu, shkak ligjor për këtë ndalim.
16. Ankuesi ngriti në seancë dy pretendime të rëndësishme lidhur me çështjen, pretendimin se Komisioneri është vënë në lëvizje me kërkesën e një subjekti që nuk disponon të drejtën ligjore për të kërkuar nisjen e procedimit, si dhe pretendimin se Komisioneri kishte ezauruar kompetencën vendimmarrëse, kur kishte vendosur pranimitim e kandidimit dhe dërgimin e formularit të vetdeklarimit për verifikim të thelluar. Të dy pretendimet nuk qëndrojnë.
17. Së pari, Komisioneri ka përshkruar në pjesën përshkruese të vendimit të tij rrugën se si ka marrë dijëni dhe se si ka thelluar hetimin për çështjen në shqyrtim. Në këtë pjesë përmendet shtetasi Eugen Likaj, i cili ka vënë në dijëni Komisionerin për rrethanat e ndalimit. Po kështu, ky shtetas është ftuar të marrë pjesë si palë e interesuar në procedimin administrativ. Ankuesi pretendon se ky subjekt nuk bën pjesë në rrethin e subjekteve të numërtuara nga pikat 1, 2 dhe 5, të nenit 7, të ligjit nr. 138/2015 dhe për këtë shkak, nuk mund të niste procedurën administrative.
18. Neni 7 i ligjit nr. 138/2015 përcakton subjektet që gëzojnë të drejtën për të kërkuar nisjen e procedurës për verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit. Kjo listë është e fundme dhe nuk lejon që të shtohen subjekte të tjera. Por, procedura që u kurorëzua me vendimin nr. 69, datë 05.07.2024 nuk është procedurë e zhvilluar në kuadër të nenit 7 të ligjit, por në kuadër të nenit 10 të tij. Për pasojë referenca tek lista e subjekteve të autorizuara të nenit 7 është e gabuar dhe çorientuese.
19. Legjitimimi i z. Eugen Likaj, nuk mund të kontestohet, duke referuar tek neni 7 i ligjit nr. 138/2015, por duke ngritur pretendimin për mungesë të interesit të ligjshëm, në kuptim të ligjit nr.

44/2015. Ky pretendim nuk u ngrit në asnje fazë të shqyrtimit administrativ dhe KAS-i nuk mund t'a analizojë atë apriori, por mund të konfirmojë në parim, se çdo zgjedhës i bashkisë Himarë është bartës i interesit të ligjshëm në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative, kur vë në diskutim mandatin e kryetarit të zgjedhur të bashkisë.

20. Së dyti, lidhur me pretendimin se Komisioneri ka vepruar në tejkalim të kompetencës ligjore kur ka marrë vendimin, sepse i kishte ezauruar instrumentat me pranimin e kandidaturës për regjistrim dhe dërgimin e formularit të vetdeklarimit për verifikim, KAS, përveçse risjell në vëmendje analizën e tij të bërë më sipër, rithekson se KQZ-ja është ngarkuar nga ligji nr. 138/2015 me detyrën për të penguar zgjedhjen ose emërimin në organet e zgjedhura shtetërore, si dhe për të kryer largimin nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve, sipas përcaktimeve në këtë ligj (neni 1). Analiza e ankuesit e redukton këtë detyrë vetëm në tagrin e KQZ-së për të administruar formularët e vetdeklarimit e për t'i përcjellë ato për verifikim, si dhe në tagrin për të vendosur lidhur me fatin e mandatit, sipas rezultateve të verifikimit të ardhura nga organi i prokurorisë. Ankuesi i heq KQZ-së thelbin e kompetencave, të gjitha kompetencat e parashikuara nga neni 10 i ligjit, thjeshtë sepse nuk lexon në ligj për to procedurë të shkruar specifikisht
21. Analiza ligjore dhe faktike e mësipërme, rrëzon të gjitha pretendimet e të dy subjekteve ankuese (ankuesi Partia “Bashkimi për të Drejtat e Njeriut” nuk paraqiti kërkitime të veçanta, të ndryshme nga ato të ankuesit Dhionisios Alfred Beleri).

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, KAS, me shumicën e votave

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 9, datë 03.08.2024 me ankues Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut;
2. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 10, datë 04.08.2024 me ankues z. Dhionisios Alfred Beleri;
3. Lënien në fuqi të vendimit nr. 69, datë 05.07.2024 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data: 12.09.2024 Nr: 20
Ora: 13:20



“Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 9, datë 03.08.2024 depozituar nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut dhe nr. 10, datë 04.08.2024 me ankues z. Dhionisios Alfred Beleri”

Bazuar në pikën 1, të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 152 të Kodit Zgjedhor

U shpall sot më 12.09.2024.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar (Kundër)
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar (Kundër)

Data: 12.09.2024 Nr: 20
Ora: 13:20



“Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 9, datë 03.08.2024 depozituar nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut dhe nr. 10, datë 04.08.2024 me ankues z. Dhionisios Alfred Beleri”

MENDIM PAKICE

Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 9, datë 03.8.2024 të paraqitur nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut e cila është bashkuar me kërkesën ankimore nr. 10, datë 04.8.2024 të paraqitur nga z. Dhionisios Alfred Beleri, me objekt *“Kundërshtimin e vendimit nr. 69, datë 05.7.2024 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të bashkisë Himarë, z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ne anëtarët në pakicë të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) jemi kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e ankimit në fjalë dhe lënien në fuqi të vendimit të KSHZ, ndaj paraqesim në vijim argumentet tona për këtë qëndrim:*

1. Ne, anëtarët në pakicë, vlerësojmë se KAS në këtë vendimmarrje nuk ka arritur në një konkluzion të drejtë kryesisht për bazën ligjore të aplikueshme në rastin konkret duke e privuar në këtë mënyrë ankimesin nga mundësia për t’iu nënshtruar një procesi të rregullt ligjor. Heqja e mandatit të Kryetarit të bashkisë nga ana e KSHZ duke u referuar në dispozitat ligjore të ligjit ligjit nr. 138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” (më tej Ligji të Dekriminalizimit)*, në opinionin e anëtarëve në pakicë, përbën në vetvete një parregullsi dhe shkelje ligjore flagrante nëpërmjet aplikimit të një procedure ekstraligjore.
2. Ligji i Dekriminalizimit ka si qëllim kryesor të tijin pengimin e zgjedhjes ose emërimit ndër të tjera në organet e zgjedhura shtetërore *(në rastin konkret organet e qeverisjes vendore)*, të individëve të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve, sipas këtij ligji. Ashtu sikurse edhe në rastin konkret, aplikimi i këtij ligji në praktikë bëhet nëpërmjet mekanizmit të *“Ndalimit për kandidim dhe për t’u zgjedhur në një funksion të lartë publik”*, të parashikuar në nenin 2 të tij. Nga vetë terminologjia e përdorur në këtë dispozitë, rezulton qartësisht e kuptueshme se ky mekanizëm përdoret dhe aplikohet me efekt parandalues *(për ndalimin/pengimin e aksesimit në këto institucione nga persona të dënuar më parë)*, çka do të thotë se ky mekanizëm ligjor mund të përdoret vetëm në momentin përpara kandidimit të një individi të caktuar në një funksion të lartë publik si deputet në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak etj.
3. Jo pa qëllim në Ligjin e Dekriminalizimit është parashikuar një procedurë e tërë paraprake *“vetëdeklarimi dhe verifikimi i të dhënave” (shiko nenin 5)*, proces që fillon nga individi i interesuar për kandidim nëpërmjet plotësimit të formularit të deklarimit, vijon me dorëzimin e formularit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve *(për të zgjedhurit dhe kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë apo në organet e qeverisjes vendore)* dhe përfundon me verifikimin e të dhënave të deklaruara nga ana Prokurorisë së Përgjithshme me kërkesën e organit kompetent, që në rastin konkret do të ishte KQZ.

4. Në këtë kontekst, duhet theksuar fakti se ashtu sikundër edhe vetë KSHZ ka pranuar dhe pasqyruar në vendimin objekt ankimi me nr. 69, datë 05.7.2024, është e provuar se ankimuesi z. Beleri i është nënshtruar mekanizmave paraprakë kontrollues të “verifikimit të të dhënave të deklaruara” të parashikuara në Ligjin e Dekriminalizimit në momentin përpara kandidimit të tij si kryetar i bashkisë Himarë duke e kaluar me sukses këtë kontroll. Kokretisht, në datën 31.03.2023, pranë KQZ nga z. Beleri është depozituar formulari e vetëdeklarimit, i cili është regjistruar me numër unik VL-BF-13387 dhe referuar konstatimeve në atë formular, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4099 prot., datë 24.04.2023, ka vendosur t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, e cila nuk ka kthyer përgjigje edhe aktualisht, çka do të thotë që ky institucion nuk ka konstatuar deri në këtë moment asnjë kusht papajtueshmërie të z. Beleri në kuptim të Ligjit të Dekriminalizimit.
5. Në këto rrethana, vetëm nëse si pasojë e verifikimit të thelluar të Prokurorisë së Përgjithshme do të ishin verifikuar kushtet për moskandidim dhe moszgjedhje, bazuar pikën 1, të nenit 10 të këtij ligji, KQZ-ja legjitimohej të shpallte pavlefshmërinë e mandatit apo përfundimin e parakohshëm të tij vetëm në dy raste që parashikohen në gërmën (ç) dhe (d) të dispozitës në fjalë:
- ç) kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe para fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi i shpallur i zgjedhur në kundërshtim me këtë nen;*
- d) kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi përkatës.*
6. Në fakt, në rastin e z. Beleri, përsa kohë që Prokuroria e Përgjithshme në cilësinë e organit kompetent për verifikimin e thelluar të të dhënave të kandidatit në formularin e dekriminalizimit nuk është shprehur, nuk jemi përpara egzistencës së kushteve të moszgjedhshmërisë në momentin e kandidimit të tij. Afërmendsh që z. Beleri në momentin e kandidimit nuk mund ta dinte dhe për rrjedhojë as nuk mund të deklaronte në formularin e dekriminalizimit të dorëzuar në KQZ në datën 31.03.2023 se në vitin 2024 do të dënohej penalisht me vendim të formës së prerë. **Në këto kushte, në anëtarët në pakicë të KAS, jemi të mendimit se kjo dispozite e përdorur nga KSHZ në vendimin objekt ankimi nuk është e aplikueshme në rastin e z. Beleri.**
7. Në respektim të pikës 3, të nenit 45 të Kushtetutës së Shqipërisë, pavarësisht mosaplikimit në rastin kokret të dispozitave të Ligjit të Dekriminalizimit të sipërpërmendura, kuadri ligjor në fuqi, i cili ka egzistuar edhe përpara miratimit të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” i ka rregulluar qartë situatat (*kushtet dhe procedurën*) e përfundimit përpara afatit të mandati të kryetarit të bashkisë. Kokretisht, neni 115 i Kushtetutes parashikon se:
- “1. Organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësisë qeverisëse vendore mund të shpërndahet ose të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve.”*

2. *Organi i shpërndarë ose i shkarkuar mund të ankohet në Gjykatën Kushtetuese brenda 15 ditëve, dhe në këtë rast vendimi i Këshillit të Ministrave pezullohet.*

3. *Në rastin e mosushtrimit të së drejtës së ankimit brenda 15 ditëve, ose në rastin e lënies në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nga Gjykata Kushtetuese, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve në njësinë vendore përkatëse.*

8. Gjithashtu, edhe në nenin 61 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikohet se mandati i kryetarit të bashkisë përfundon përpara afatit në rastet kur kryetari shkarkohet, sipas nenit 62 të këtij ligji. Për rastet e përfundimit të mandatit të kryetarit përpara afatit, këshilli bashkiak njofton Këshillin e Ministrave nëpërmjet prefektit. Është më pas Këshilli i Ministrave, i cili sipas nenit 62 të po këtij ligji dhe të pikës 1, të nenit 115 të Kushtetutës, me vendim shkarkon kryetarin e bashkisë kur ai dënohet për kryerjen e një vepre penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë. Më tej, sërish sipas parashikimeve të nenit 61 të këtij ligji, në rastet e përfundimit të parakohshëm të mandatit, organizohen zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e bashkisë, në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Kjo do të ishte procedura korrekte e cila duhet të aplikohet në rastin e z. Beleri, procedurë e cila do të bënte të mundur zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor ndaj tij duke mos i mohuar në këtë mënyrë të drejtën e parashikuar në pikën 2, të nenit 115 të Kushtetutës.
9. Si përfundim, sipas opinionit të anëtarëve në pakicë të KAS, duke qenë se në rastin objekt shqyrtimi ligji i zbatueshem nuk është ligji i Dekriminalizimit por ligji për vetëqeverisjen vendore, për rrjedhojë, organi kompetent për të proceduar në këtë fazë të procesit nuk është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, por Këshilli i Ministrave.
10. Për këto arsye, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se vendimi nr. 69/2024 i KSHZ është një akt i paligjshëm në kuptim të nenit 109, të KPrA është nxjerrë në aplikim të gabuar të ligjit dhe për këto arsye KAS duhet të kishte vendosur pranimin e kërkesës ankimore nr. 9, datë 03.8.2024 të paraqitur nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut dhe nr. 10, datë 04.8.2024 të paraqitur nga z. Dhionisios Alfred Beleri dhe shfuqizimin e vendimit nr. 69, datë 05.7.2024 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të bashkisë Himarë, z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar